



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.SHk.II.nr.302/22

GJYKATA KOMERCIALE – Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike të kreditorit të kundërpërbarimit KS. “Insig” sh.a – Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit të kundër përbarimit KS. “Siguria” në Prishtinë, për shkak të kundërpërbarimit në të holla, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, E.nr.2068/10 të datës 28.05.2021, me datë 25.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e kreditorit KS. “Insig” sh.a – Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, E.nr.2068/10 të datës 28.05.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, E.nr.2068/10 të datës 28.05.2021, ka vendosur si në vijim: “Konsiderohet i tërhequr propozimi për kundërpërbarim i kreditorit të kundërpërbarimit KS. “Insig”, sh.a dega në Kosovë dhe abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra përbarimore.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të priset aktvendimi i atakuar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori i kundërpërbarimit KS. “Insig” sh.a – Dega në Kosovë, ka paraqitur propozim për kundërpërbarim, ndaj debitorit KS. “Siguria” në Prishtinë, në bazë të dokumentit përbarues Rev.nr.295/08 të dt. 17.01.2011, për shumën e detyrimit në vlerë prej 21.211.18, me kamatë dhe rentë shumën prej 4.169.44 euro.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me konkluzionin E.nr.2068/10 të dt. 25.03.2021, ka urdhëruar kreditorin e kundërpërbarimit që në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij konkluzioni të njofton gjykatën se a ekziston ende interesi juridik, nëse po ta njofton gjykatën se a ka përmbushur në tërësi ose pjesërisht debitori i kundërpërbarimit detyrimin që ka ndaj juve si kreditori i kundërpërbarimit, ta dorëzon në origjinal ose kopje të vërtetar sipas ligjit aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.295/08 dt. 17.01.2011, me vërejtjen se nëse nuk vepron sipas këtij konkluzioni, propozimin për përbarim gjykata do ta konsideroj të tërhequr.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin E.nr.2068/10 të datës 28.05.2021, e ka konsideruar të tërhequr propozimin e kreditorit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të ankimuar ndër të tjera ka theksuar se: kreditori i kundërpërbarimit nuk ka vepruar sipas konkluzionit të lartpërmendur në pajtim me dispozitat 2.4 dhe 102.3 të LPK –së, lidhur me nenin 17 dhe 36.1 të LPP –së, ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore që propozimi për kundër përbarim të konsiderohet i tërhequr dha ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsye se kreditori i kundërpërbarimit duke mos vepruar sipas konkluzionit ka treguar se nuk ka interes juridik në këtë çështje kundërpërbarimore i cili duhet të ekzistoj në secilën fazë të procedurës.

Gjykata e shkallës së parë aktvendimin e saj e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga neni 102.3 të LPK-së, si dhe neni 17 të LPP-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e as aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallës së dytë e kësaj gjykate, duke u mbështetur në dispozitën ligjore të nenit 102. par.1 dhe 3 të LPK-së, të cilat përshtatshmërisht zbatohen edhe në procedurën përbarimore sipas nenit 17 të LPP –së, përcakton se citoj *102.1 Kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigojë ose ta plotësojë parashtrësën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e*

udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtresës”, si dhe 102.3 “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë”, gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur lidhur me këtë çështje juridike – përmbartimore duke e konsideruar të tërhequr propozimin për përmbartim të kreditorit.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar drejtë ka vendosur kur e ka konsideruar propozimin për përmbartim të kreditorit të tërhequr sepse nga provat- fletë kthesat, edhe kjo gjykatë ka konstatuar se pala kreditore është ftuar për vërejtjet sipas konkluzionit, duke i caktuar afat 7 ditorë, ndërsa i njëjti brenda këtij afati nuk ka vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës, andaj me të drejtë propozimi për përmbartim i është konsideruar i tërhequr nga gjykata e shkallës së parë.

Në raport me pretendimet e kreditorit se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vepruar kur e ka konsideruar të tërhequr propozimin për përmbartim, pasi që kreditori ka dorëzuar parashtresën e dt. 08.04.2021 me nr. protolli 241, prandaj nuk ka pasur arsye për tu konsideruar i tërhequr propozimi, Dhoma e shkallës së dytë i refuzon si të pa bazuara, për faktin se në rastin konkret kreditori përmes konkluzionit ka pasur një afat të caktuar prej 7 dite brenda të cilit është dashur të veproj lidhur me vërejtjet e gjykatës. I njëjti konkluzionin e ka pranuar me datë 31.03.2021, ndërsa parashtresën përmes postës në gjykatë e ka parashtruar me datë 08.04.2021, që rezulton se e njëjta është dorëzuar pas afatit të dhënë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, konkretisht 1 ditë me vonesë pra në ditën e 8 (tetë).

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i shqyrtoi me kujdes edhe pretendimet e tjera të kreditorit në ankesë por të njëjta nuk kishin ndonjë bazë që të vendosët ndryshe. Edhe vet pala pra kreditori në ankesë pranon se gjykatën e ka njoftuar përmes parashtresës së dt. 08.04.2021. Për me tepër kreditori ka pasur mundësi që të parashtron propozim për kthim në gjendje të mëparshme për lëshim të afatit për të vepruar por nuk e ka bërë një gjë të tillë, prandaj kjo gjykatë nuk i ka pranuar si të themelta pretendimet ankimore, ndërsa aktvendimin e ankimuar vendosi ta vërtetoj.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) , të LPK-së në kuptim të nenit 17 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.SHk.II.nr.302/22, me datë 25.08.2022

Gjyqtari
Krenar Berisha